



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:096723  
Datë: 09.01.2024  
Numri i dokumentit: 05168774

**SCC - 09 – 0037**

**Paditësi:**

K R nga Prishtina, e me trashëgimtarin B R nga Prishtina, e të cilin me autorizim e përfaqëson, nga av.Z B nga Prishtina.

**Kundër:**

**Të paditurve:**

”MDD Ratar”, Shoqëri Akcionare me seli në fshatin LI të Komunës së Prishtinës, dhe Kombinati Bujqësor Industrial, (KBI), ”KOSOVA EXPORT” me seli në Fushë Kosovë e të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr.”Agim Ramadani”, nr.23, Prishtinë.

**Personi i tretë që të jetë palë në procesin kontestimor, si ndërhyrëse kryesore:** A M nga, Shkup, Republika e Maqedonisë.

Për : Ndërhyrësn kryesore, A M nga Shkupi.

**Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në Lidhje me Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), me Kolegjin në përbërje nga gjykatësi, Agron Hoxhaj, - kryesues, gjykatësin, Asllan Krasniqi - anëtar dhe gjykatësin, Bajram Miftari - anëtar, në seancën vendimmarrëse të mbajtur me dt.09.01.2023, mori këtë:**

**A K T V E N D I M**

**I. I JEPET për detyrë, personit të tretë, A M nga Shkupi, palë në procesin kontestimor, SCC – 09 – 0037 dhe si ndërhyrëse kryesore, që të bëjë plotësimin e propozimit të saj të datës 04.11.2011 për ndërhyrje kryesore në procesin kontestimor, SCC – 09 – 0037, ku edhe duhet të specifikoj si ndërhyrëse kryesore, se cila është kërkesa e saj themelore pasi që si ndërhyrëse kryesore, duhet të dorëzoj padinë e kompletuar, dhe të sqaroj çështje të tjera të cilat duhet të përfshijë kërkesa për ndërhyrje kryesore, sipas dispozitave ligjore të aplikueshme.**

**II. Plotësimi i parashtrësës së dt.04.11.2011 për ndërhyrje kryesore, në procesin kontestimor, SCC – 09 – 0037, duhet të bëhet brenda afatit prej **30 (tri dhjetë) ditëve**, pas ditës së pranimit**

të këtij aktvendimi, me vërejtjen se në qoftë se nuk ndërmerren veprimet procedurale brenda këtij afati, do të vendoset mbi rastin në pajtim me dispozitat ligjore të aplikueshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).

### **Rrethanat procedurale dhe faktike të çështjes**

Me dt.13.03.2009, paditësi, K R nga Prishtina, pranë DhPGJSK-së, ka paraqitur padinë për kthimin e tokës dhe dhënien e tapisë për patundëshmërinë në ngastrën kadastrale, arë e cila gjendet në vendin e quajtur, " L " në sipërfaqe prej 0,30 ha dhe ngastrën kadastrale, tokë e punueshme në vendin e quajtur, " A e S – Suljiva njiva " afrër fshatit Çagllavicë, në sipërfaqe prej 0,60 ha dhe e cila i ishte konfiskuar më 18 Gusht 1954 me qëllim të Reformës së Tokave dhe kolonizimit të brendëshëm të ish Republikës Popullore të Serbisë më 1945 dhe ishte e regjistruar në findin e Tokës Bujqësore dhe ka kërkuar që t'i kthehet toka atij.

Përmes kësaj padie, ai ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e tij dhe të vërtetohet se Vendimi i Këshillit Popullor i Komunës së atëhershme të Graçanicës, Nr.238/54 i dt.19.01.1954 për marrjen e patundshmërive në emër të reformës agrare dhe dhe kolonizimit të brendëshëm dhe përfshirjes në Fondine e Tokës Bujqësore – pasurisë popullore ka kompensim, të shpallet nul – i pa vlefshëm.

Me dt.31.03.2009, DhPGJSK-ja, me urdhrin e saj, SCC – 09 – 0037 të dt.31.03.2009, ka urdhruar paditësin që të bëjë evitimin e të metave në padinë e tij etj si dhe siguroj të dhëna për patundëshmërinë gjegjëse.

Me dt.14.04.2009, paditësi e ka bërë plotësimin e padiës së tij dhe se parashtrësës së dt.14.04.2009, ia ka bashkangjitur Njotimin e drejtuar AKP-së për inicimin dhe procedimin e lëndëve në GJKP dhe në Dhomen e Posaçme, Ekstraktin nga fleta poseduese, Nr... të Entit Republikan të Gjeodezisë në Beograd për patundëshmërinë në ngast.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,68.68 ha dhe për patundëshmërinë në ngast.kad.nr... në sipërfaqe prej 0,28.01 ha, kopjen e aktvendimit, Nr.238 të dt.19 - I – 1954 të Këshillit Popullor të Komunës së Graçanicës për marrjen e tokës së paditësit, regjistrat gjegjës së bashku me skicat e patundshmërive gjegjëse.

Me dt.18.04.2009, paditësi ka bërë kërkesëpër lirim nga pagimii taksës gjyqësore prpadi si dhe për përkthimin e dokumentacionit për këtë lëndë.

Me dt.06.10.2009, DhPGJSK-ja me aktvendimin e saj, SCC – 09 – 0037 të dt.06.10.2009, ia ka pranuar kërkesën e paditësit për përkujdesje për përkthimin e dokumenteve.

Me dt.16.02.2010, i autorizuari i paditësit, av. B E nga Prishtina i është drejtuar kësaj gjykate me parashtrësën e dt.12.02.2010 e në të cilën e njofton gjykatënsë heq dorënga përfaqësimi i paditësit në këtë lëndë.

Me dt.04.10.2010, DhPGJSK-ja me aktvendimin e saj, SCC – 09 – 0037 të dt.04.02.2010, padinë e paditësit, e ka refuzuar si të pa pranueshme e më gjerësisht si në arsyetimin e këtij aktvendimi.

Me dt.08.03.2010, kundër aktvendimit e kësaj gjykate, SCC – 09 – 0037 të dt.04.02.2010, paditësi, ka paraqitur ankesë derisa Kolegji i Ankesave i DhPGJSK-së, me aktvendimi e tij, ASC – 10 – 0032 të dt.17 Gusht 2010, ankesën e paditësit e ka pranuar si të bazuar, ka hedhur

poshtë aktvendimin e kësaj gjykate, SCC – 09 – 0037 të dt.04.02.2010, e ka urdhëruar trupin gjykues, që t'a ri gjykoj padinë si dhe që të vendos për shumën e shpenzimeve në procedurën e shkallës së parë e më gjerësisht si në këtë aktvendim.

Me dt.03.12.2010, e paditira, AKP-ja, ka paraqitur Mbrojtjen e saj në padinë e paditësit.

Me dt.04.11.2011, DhPGJSK-së, i është drejtuar A M nga Shkupime parashtrësën e dt.03.11.2011 e me të cilën ka kërkuar që të jetë ndërhyrëse kryesore në procesin kontestimor.

Me dt.12.12.2013, DhPGJSK-ja me Urdhrin e saj, SCC- 09 – 0037 të dt.12.12.2013, mbrojtjen e të paditurës, ia ka dërguar paditësit si dhe ndërhyrësës kryesore për mundësinë e paraqitjes së Përgjigje në mbrojtje.

Me dt.15.08.2015, ndërhyrësja kryesore, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtrësë e në të cilën ka sqaruar se e ka pranuar vetëm në gjuhën Shqipe një shkresë të kësaj gjykate e duke kërkuar që e njëjta t'i dërgohet edhe në gjuhën serbe.

Me dt.12.09.2017, DhPGJSK-ja, ka caktuar seancën dëgjimore e në të cilën në mes tjerash, B R, ka deklaruar se K R ka vdekur.

Me dt.14.09.2017, kësaj gjykate, me parashtrësën e dt.12.09.2017 i është drejtuar personi i quajtur, M L dhe i cili e njofton gjykatën se ai e përfaqëson B R si dhe se ka bërë një gabim teknik me rastin e përpilimit të padisë në lëndën C – 0073/2017 (ashtu e ka shkruar), ashtu që e ka shkruar (jo nënshkruar) emrin dhe mbiemrin e R K.

Me dt.13.10.2017, kësaj gjykate i është drejtuar me parashtrësë gjegjëse, av.V V nga Prishtina, në cilës të të autorizuarit të B R e të cilës ia ka bashkagjitur autorizimin e dt.07.10.2017.

Me dt.30.10.2017, kësaj gjykate, i është drejtuar av.V V nga Prishtina, i autorizuar i B R, trashëgimtar i paditësit, dhe atë me parashtrësën gjegjëse e përmes së cillës ka kërkuar shtyrjen e seancës së caktuar me dt.31.10.2017.

Me dt.31.10.2017, është mbajtur seanca e radhës e në të cilën si i autorizuar i B R trashëgimtar i paditësit, është paraqitur av. Z B nga Prishtina.

Me dt.09.01.2018, DhPGJSK-ja, ka caktuar seancën e radhës por me parashtrësën e dt.09.01.2018, av. Z B nga Prishtina, ka kërkuar shtyerjen e seancës sikurse që ka kërkuar edhe ndërhyrësja kryesore me parashtrësën e dt.03.01.2018 dhe e cila është shtyer dhe caktuar seanca tjetër me dt.06.02.2018.

Me dt.24.01.2018, ndërhyrësja kryesore me parashtrësën e dt.23.01.2018, i është drejtuar kësaj gjykate e duke kërkuar shtyerjen e seancës së radhës.

Me dt.20.02.2018, DhPGJSK-ja, ka caktuar seancën e radhës dëgjimore për fjalën përfundimtare por se ndërhyrësja kryesore, përmes komunikimit me e mail, ka kërkuar shtyrjen e saj për 3 (tre) muaj dhe se kësaj parashtrëse, ia ka bashkangjitur aktvendimin e Fondit Shëndetësor në Shkup, UP – 1 Nr.19-691 të dt.26.01.2018 për çështjen e trajtimit të saj shëndetësor.

Me dt.20.02.2018, DhPGJSK-ja, ka mbajtur seancën dëgjimore e në të cilën nuk ka marr pjesë as pala paditëse si dhe as ndërhyrësja kryesore por ka marr pjesë pala e paditur, AKP-ja dhe e cila përmes përfaqësuesit të saj, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar ose padia e paditësit të konsiderohet si e tërhequr për shkak të mos pjesëmarrjes në këtë seance dhe se në procesverbalin e dt.20.02.2018 të kësaj seance, gjykatësi kryesues, ka vendosur që të përfundoj seancën dhe do t'i informoj palët për vendimin që të lëshohet nga trupi gjykues dhe do t'iu shpërndahej palëve dhe se që nga dt.20.02.2018, gjykata nuk ka marrë asnjë vendim në këtë çështje juridike kontestimore.

## **Arsyetimi ligjor**

Ne bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Procedura gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si ligj i veçantë.

Sipas nenit 6 paragrafi 2.5 të Ligjit (nr. 06/L-086) për DHPGJS, i paditur në procedurat para DhPGJSK-së, është në kuptimin e cilit do rast apo çështje para saj: *“Secili person të cilin DhPGJS apo ndonjë koleg i saj e konsideron të domosdoshëm apo të përshtatshëm për ta pranuar si Palë Kundërshtare (paditur) me qëllim të sigurimit të gjykimit të plotë dhe të saktë të rastit apo çështjes në fjalë”*.

Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm, zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr.03/L-006), me Ndryshimet dhe Plotësimet e këtij ligji dhe se kjo çështje është definuar me nenin 76 paragrafi 3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është theksuar, se *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet njaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Me nenin 271 par.1 të LPK-së, është përcaktuar se: *“Kushdo mund të ndërhyjë në një proces kontestimor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur ka interes juridik për të mbështetur njëren ose tjetrën palë ndërgjyqëse, me të cilën bashkohet në gjykim për ta ndihmuar atë”*. Pastaj, me nenin 266 par.1 të LPK-së, është përcaktuar se: *“Personi që tërësisht apo pjesërisht e kërkon sendin apo të drejtën lidhur me të cilën është në zhvillim e sipër procedura midis dy palëve ndërgjyqëse, mundet që në gjykatën e çështjes t'i padisë ato me padinë e tij deri në përfundimin e procedurës me vendim të formës së prerë (ndërhyrja kryesore)”*. Ky aktvendim është marrë në zbatim të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ku është përcaktuar: *“Kur një parashtresë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtresën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhe treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtresës ... Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të*

*hidhet poshtë...". Në shqyrtimin e parashtresës - propozimit të datës 04.11.2011 së A M nga Shkupi, që të jetë për ndërhyrëse kryesore në procesin kontestimor, SCC – 09 – 0037, gjykata ka vlerësuar se të njëjtës i mungojnë të dhënat e nevojshme që duhet të ketë një parashtresë, siç kërkohet me nenin 35 par.2 dhe 36 par.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), si dhe me dispozitat e LPK-së që rregullojnë ndërhyrjen në një proces kontestimor pasi që propozimi i këtij personi të tretë që të jetë ndërhyrëse kryesore në procesin kontestimor, SCC – 09 – 0037, nuk është në pajtim me nenin 266 të LPK-së, dispozitë kjo që kërkon edhe ushtrimin e padisë nga ana e një ndërhyrëseje kryesore, siç është në rastin konkret. Pra, në këtë çështje juridike kontestimore, nuk është parashtruar kërkesa themelore e ndërhyrëses kryesore por vetëm kërkesa që të jetë ndërhyrës kryesore në këtë proces kontestimor. Andaj duke qenë se mungesa e të dhënave të cekura në parashtresë, i bënë të pamundur gjykatës që të zhvilloj veprimet përkatëse procedurale, e për këtë arsye, ndërhyrëses kryesore, A M nga Shkupi, iu dha detyra që të bëjë plotësimin e parashtresës për të qenë ndërhyrëse kryesore në procesin gjyqësor kontestimor, SCC – 09 - 077.*

Prandaj, nga të gjitha arsyet e thëna më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 9, 35, 36, dhe nenit 76 par.3 të Ligjit, nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 99, 102 lidhur me nenin 266 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

**DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS**  
**2023:096723, 09.01.2024**

**Kolegji i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykatësi kryesues, Agron Hoxhaj \_\_\_\_\_

Gjyqtari, Asllan Krasniqi \_\_\_\_\_

Gjykatësi, Bajram Miftari \_\_\_\_\_

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi, nuk lejohet paraqitja e ankesës në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit, Nr.06/L- 086 të DhPGJSK-së lidhur me nenin 387 par.2 të LPK-së.